

# Aksidentet Rrugore

## Korrik 2017

**Tiranë, më 18 Gusht 2017:** Në muajin Korrik 2017 numërohen 199 aksidente rrugore. Në krahasim me Korrik 2016, numri i aksidenteve është rritur me 7,6 %.

Numri i të aksidentuarve është 272 persona nga 281 që ishte një vit më parë.

Në shtatëmuajorin e 2017, numri i të aksidentuarve është ulur 4,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Numri i personave të vdekur gjatë muajit Korrik 2017 është 22. Krahasuar me mesataren e personave të vdekur gjatë vitit 2016, ky numër është ulur me 1,9 %.

Në Korrik, aksidentet rrugore, në 81,9 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup mosha 25 – 35 vjeç duke zënë 26,6 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke u rritur me 17,8 %, në krahasim me një njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në shtatëmuajorin e 2017, aksidentet rrugore të cilat kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit, zënë 80,2 % të rasteve. Numri më i lartë i aksidenteve është kryer nga grup mosha 25 – 35 vjeç duke zënë 28,0 % të numrit të aksidenteve rrugore dhe duke ulur me 5,5 % me njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në Korrik 2017, numri i të aksidentuarve për 100.000 banorë ishte afërsisht 9 persona. Krahasuar me mesataren e vitit 2016, ky numër u rrit me 17,2 %.

**Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Korrik 2013 - Korrik 2017**



**Tab. 1 Aksidentet rugore, Korrik 2017**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Korrik - 2016	185	9	18	90	164	
Korrik - 2017	199	3	19	69	181	
Ndryshimi vjetor (%)	7,6	-66,7	5,6	-23,3	10,4	
Janar - Korrik 2016	1.113	27	130	445	936	
Janar - Korrik 2017	1.098	23	104	406	944	
Ndryshimi vjetor progresive (%)	-1,3	-14,8	-20,0	-8,8	0,9	

**Tab. 2 Aksidentet rugore sipas përdoruesve të rugës, Korrik 2017**

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur sipas	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Korrik - 2016	160	25	9	18
Korrik - 2017	163	36	3	19
Janar - Korrik 2016	952	161	128	29
Janar - Korrik 2017	881	217	104	23

**Tab. 3 Aksidentet rugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit, Korrik 2017**

Periudha	0 - 16 vjeç	16 - 25 vjeç	25- 35 vjeç	35- 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Korrik - 2016	4	39	45	38	34	18	7
Korrik - 2017	0	37	53	38	39	25	7
Janar - Korrik 2016	8	213	325	185	223	84	75
Janar - Korrik 2017	4	251	307	176	209	92	59

**Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve, Korrik 2017**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Korrik-16	Korrik-17	Korrik-16	Korrik-17	Janar-Korrik 2016	Janar-Korrik 2017	Janar-Korrik 2016	Janar-Korrik 2017
Shqipëria	185	199	27	22	1.113	1.098	157	127
Tiranë	58	67	3	2	396	434	38	24
Durrës	21	28	2	3	160	150	22	12
Shkodër	11	6	3	3	64	32	14	14
Elbasan	16	15	0	1	80	96	6	12
Fier	21	16	4	3	79	63	14	17
Vlorë	8	17	3	2	47	67	10	9
Korce	12	8	1	0	83	48	13	7
Lezhë	19	28	4	4	113	119	19	17
Berat	5	4	2	0	31	27	5	0
Kukës	4	5	1	1	24	24	3	3
Diber	2	2	0	1	16	19	3	1
Gjirokastrë	8	3	4	2	20	19	10	11

# Përkufizime

**Aksidente:** Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

**I vdekur:** I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

**I plagosur:** I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.*